



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:290726

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05629511

KPPP.nr. 1651/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.A., me numër të biznesit 71102130 dhe seli në Prishtinë, Bulevardi Bill Klinton, nr. 5, Ndërtesa Elektrokosova, kati VII, kundër debitorit N.T.SH.FK-ANA, F.M.K., me adresë në Drenas, Sankofc, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar ndaj Urdhrit Përbarimor P.nr. 506/21, i lejuar me datë 07.12.2021, nga Përbaruesi Privat Isa Shala, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datë 26.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.SH.FK-ANA - F.M.K., ashtu që Urdhri Përbarimor P.nr. 506/21, i lejuar me datë 07.12.2021, nga Përbaruesi Privat Isa Shala, SHFUQIZOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, mbi bazën e dokumentit të besueshëm – ekstraktit nga librat afariste të kreditorit DPR-..., ka lejuar Urdhrin për Përbarim P.nr. 506/21, të datës 07.12.2021, me të cilin është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, t'ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 2,750.24 në emër të borxhit, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e kalimit të afatit për pagesë e deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përbarimit, me arsyetim se shuma si në propozimin për përbarim rrjedh që nga viti 2016 dhe se borxhi është parashkruar. Më tej, ka theksuar se për shkak të defekteve teknike të njehsorit energjia elektrike nuk është faturuar nga kreditori, andaj i njëjti e ka ngarkuar pa bazë

ligjore dhe ka faturuar borxhin në shumën si në propozimin për përmbaerim. Ka shtuar se meqenëse borxhi përfshinë ngarkesat për borxhin e vitit 2016, ndërsa propozimi për përmbaerim është paraqitur me datë 07.12.2021, gjykata duhet të trajtojë parashkrimin sipas nenit 360 të LMD-së, duke qenë se ka kaluar afati një vjeçar për kërkimin e borxhit. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ndërsa urdhri përmbaerimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim e ka theksuar se pretendimet e debitorit janë të pabazuara, dhe të pa mbështetura në prova. Ka theksuar se urdhri përmbaerimor është lejuar në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht ekstraktit nga librat afarist duke u bazuar në nenin 29, par. 1.2 të LPP-së, e për më tepër në transaksionet e debitorit asnjëherë nuk ka pasur ankesa të parashtruara për kontestim të borxhit. Ka shtuar se debitori me datë 18.11.2021 ka bërë pagesë në drejtim të përmbushjes së obligimit dhe atë në vlerë prej 253.00 €, ku me pagesa vullnetare të debitorit është e mjaftueshme për të manifestuar pranimin e borxhit, duke ndërprerë parashkrimin, ashtu siç përcaktohet me nenin 368 të LMD-së. Duke qenë se kundërshtimi i debitorit është i paargumentuar dhe i pa bazuar, ka propozuar që urdhri përmbaerimor në mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes së kreditorit në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaerimore, (në tekstin e mëtejme: “LPP”) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbaerimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, *Propozimi për përmbaerim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbaerim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbaerimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbaerimi, kërkuesi i përmbaerimit dhe debitori, adresa e vendbanimit – vendqëndrimit apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjeti nëpërmjet cilit duhet kryer përmbaerimi, objekti i përmbaerimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbaerimit. 2. Në rast se propozimi për përmbaerim nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuesit dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbaerues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.*

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbarrimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1, ngase në propozim për përmbarrim kreditori nuk i ka treguar të dhëna e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, përkatësisht propozimi për përmbarrim është ushtruar ndaj N.T.SH.FK-ANA, F.M.K., me adresë në Drenas, Sankofc, duke mos treguar të dhënat e tjera të debitorit. Në vlerësimin e gjykatës, vetëm përshkrimi i debitorit N.T.SH.FK-ANA, F.M.K., pa treguar numrin e biznesit apo identifikues të debitorit, nuk është i mjaftueshëm për identifikimin e saktë të debitorit. Poashtu, referuar përmbajtjes së propozimit për përmbarrim, nuk është treguar nëse propozimi është paraqitur ndaj dy debitorëve dhe atë N.T.SH.FK-ANA si person juridik dhe F.M.K. person fizik, dhe nëse është kërkuar përmbushja në mënyrë solidare prej tyre, apo nëse propozimi është paraqitur vetëm ndaj debitorit N.T.SH.FK-ANA me pronar F.M.K.. Si rezultat i këtyre të metave, propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet nga neni 38 i LPP-së.

Më tej, me dispozitën nga neni 43, paragrafi 4 të LPP-së, përcaktohet se *“Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbarrueshmërisë së nxjerrë nga përmbarruesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbarrimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbarruesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbarrim nga përmbarruesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Nisur nga kjo dispozitë, gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarrimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbarrim nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit dhe nuk është treguar në mënyrë të saktë nëse propozimi është paraqitur ndaj dy debitorëve të përmbarrimit, dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarrim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së, të cilat tani nuk mund të evitohen, ngase gjykata në fazën e procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrin. Andaj, duke qenë se urdhri përmbarrimor është nxjerr pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi duke shfuqizuar urdhrin përmbarrimor.

Gjykata vlerëson se është detyrim ligjor i përmbarruesit privat që, para lejimi të urdhrin përmbarrimor, të vlerësoj nëse propozimi për përmbarrim i paraqitur nga kreditori i plotëson kërkesat nga neni 38, paragrafi 1 i LPP-së, dhe në rast se propozimi nuk është paraqitur konform kësaj dispozite, atëherë duhet që të veprohet sipas nenit 38, paragrafi 2 të LPP-së, lidhur me nenin

102, paragrafi 1 të LPK-së, duke e ftuar kreditorin që të bëjë plotësimin e propozimit për përmbarrim duke emërtuar saktë debitorin e përmbarrimit.

Veç të metave në kuptim të nenit 38 të LPP-së, gjykata gjithashtu gjen se dokumenti, përkatësisht ekstrakti në bazë të së cilit është lejuar propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbarrim në kuptim të nenit 29, pika 1.2 të LPP-së, për faktin se përmban të meta në raport me objektin e detyrimit, përkatësisht i njëjti ekstrakt nuk pasqyron borxhin e debitorit si rezultat i furnizimit me energji elektrike, mirëpo në ekstrakt është ngarkuar borxhi në emër të rikthimit të humbjeve. Ndërsa edhe shuma e kërkuar në propozim për përmbarrim nga ana e kreditorit nuk përputhet me shumën e pasqyruar në ekstraktin mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri, ngase në propozim kreditori ka kërkuar përmbushjen e borxhit prej EUR 2,750.24 për periudhën kohore prej datës 01.08.2021 deri më 16.11.2021, ndërsa në ekstrakt rezulton se kjo pjesë e detyrimit i takon periudhës kohore të mëhershme dhe nuk pasqyron saktë detyrimin e debitorit për shpenzimet e konsumit të energjisë elektrike për periudhën kohore për të cilën është kërkuar përmbushja.

Nga sa më sipër, gjykata në mbështetje të nenit 43 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1651/23, datë 26.04.2024

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.